



QYTETI I SHKUPIT

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për subvencionimin e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2021 me nr. 08-3310/1 nga data 16.04.2021, dhe në lidhje me Vendimin për përcaktimin e vlerës maksimale për ndarjen e subvencionit individual qytetarëve për blerjen e biçikletave në vitin 2021 („Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 5/21), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2021

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim që të stimulojë qytetarët e qytetit të Shkupit për përdorimin e biçikletave, qytetarëve të cilët do të blejnë biçikletë të re nga Republika e Maqedonisë së Veriut nga data 01.01.2021 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, do t'u kompensojë një pjesë të shpenzimeve të bëra për blerjen e biçikletës.

1.2. Mjetet që do t'i subvencionojë Qyteti i Shkupit janë në vlerën prej 50% të vlerës së biçikletës, po jo më shumë se 3.000,00 denarë për person, me tatimin mbi të ardhurat personale të përfshirë.

1.3. Aplikimet për Thirrjen publike do të shqyrtohen sipas renditjes së datës dhe kohës së arritjes.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët do të blejnë biçikletë të re nga Republika e Maqedonisë së Veriut deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, dhe të cilët plotësojnë kushtet e kësaj Thirrjeje publike.

3. Kushte që duhet t'i plotësojë aplikuesi

Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë banor i Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare),
- të mos ketë shfrytëzuar subvencion për blerjen e biçikletës nga Qyteti i Shkupit,
- biçikletën e re ta ketë blerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga 01.01.2021 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike.

4. Mënyra e aplikimit për Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të provuar se kushtet për pjesëmarrje janë plotësuar, aplikuesi është i obliguar të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- aplikim i plotësuar për subvencionim për blerjen e një biçiklete me të dhënat personale (aplikimi do të jetë në dispozicion nëpërmjet: faqes së internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk, aplikacioni skopjelab.mk ose direkt në link-un <https://aplikacii.skopjelab.mk/velosipedi/>),
- dëshmi që është banor i qytetit të Shkupit, duke bashkëngjitur fotografi të kartës së identitetit të vlefshme të aplikuesit,
- foto e bashkëngjitur e llogarisë së transaksionit të aplikuesit,
- dëshmi se është realizuar blerja e biçikletës së re nga Republika e Maqedonisë së Veriut, duke bashkëngjitur foto të faturës fiskale të lëshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me datë nga 01.01.2021 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, ku është e detyrueshme që biçikleta të jetë paguar plotësisht, kurse pagimi në këste nuk pranohet.

4.2. Një person mund të aplikojë vetëm njëherë për marrjen e subvencionit për blerjen e një biçiklete.

4.3. Aplikimin për blerjen e biçikletave së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, qytetarët e plotësojnë dhe depozitojnë pranë Komisionit nëpërmjet një link-u të veçantë me qëllim aplikimin për subvencione për blerjen e biçikletave.

4.4. Link-u do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit: www.skopje.gov.mk nga fillimi deri në përfundimin e Thirrjes publike.

4.5. Sistemi i Qytetit të Shkupit aplikimet e pranuar do t'i evidentojë me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta), për arsye të vendosjes së renditjes sipas së cilës do të shqyrtohen aplikimet.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Për realizimin e Thirrjes publike Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes publike për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2021.

5.2. Qyteti i Shkupit, në varësi të dinamikës së arritjes së aplikimeve, në mënyrë periodike do të njoftojë publikun për mjetet e mbetura, deri në shfrytëzimin e tërësishëm të tyre.

5.3. Pagimi i mjeteve do të realizohet në mënyrë succesive, sipas rendit të aplikimeve të depozituara, deri në plotësimin e buxhetit të parashikuar për këtë qëllim.

5.4. Kur do të shterohen të gjitha mjetet e parashikuara financiare, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike nëpërmjet ueb-faqes së tij.

Mjetet financiare do të konsiderohen si të shteruara, përkatësisht të ndara kur me propozimin e Komisionit, Kryetari i Qytetit do të sjellë aktvendim për pagimin e mjeteve.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës për kompensim

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të sjellë aktvendim për miratimin e kërkesës së aplikuesve, të cilët kanë plotësuar kushtet në bazë të Thirrjes publike.

6.2. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të njoftojë aplikuesit, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet në bazë të Thirrjes publike për mosmiratimin e aplikimit të tyre.

QYTETI SHKUPIT